

KËSHILLI PËR BASHKËPUNIM SHOQËRI CIVILE-QEVERI

Mekanizmi kryesor që do ta koordinojë të gjithë procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile do të jetë Këshilli për bashkëpunim qeveri–shoqëri civile.

Mandati i Këshillit nuk kufizohet vetëm në zbatimin e strategjisë qeveritare, por ai do të mbulojë të gjitha aspektet e bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile duke përfshirë:

- Monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023;
- Dhënien e opinionëve dhe këshillave për projektligjet, dokumentet strategjike dhe dokumentet tjera që ndikojnë në punën dhe zhvillimin e OSHC-ve, me qëllim të krijimit të një mjedisi më të përshtatshëm për shoqërinë civile në Kosovë;
- Jep opinion për raportet vjetore mbi shpërndarjen e fondeve publike për mbështetjen e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve.

Këshilli mblihet dhe funksionon në bazë të rregullave të punës të miratuara bashkë me këtë strategji.

Anëtarët e Këshillit po ashtu janë të ndarë në katër grupe punuese sipas katër objektivave strategjike.

Derisa takimet e rregullta të këshillit janë formale puna kryesore e anëtarëve të këshillit është e fokusuar përmes grupeve punuese.

Secili anëtar i emëruar në grupet e punës do të marr pjesë në takimet e Këshillit dhe në aktivitetet e tjera për të siguruar përkushtimin e plotë të gjitha palëve të interesuara.

PLANI I VEPRIMIT TË STRATEGJISË QEVERITARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023

Strategjia qeveritare ka një plan të veprimit të përgjithshëm si dhe një plan të punës për çdo vit kalendarik. Strategjia do të ketë një vlerësim afatmesëm dhe një vlerësim final.

Nën koordinimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe me përkrahjen e Ekipeve të punës përgatiten Raportet e monitorimit të cilat dorëzohen në Këshill në baza vjetore.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, e cili ka rolin kyç koordinues për zbatimin e Strategjisë/planit të veprimit dhe rrjedhimisht është përgjegjëse për të siguruar ose koordinuar qasjen në të dhënat për grupet punuese për të qenë në gjendje t'i kryejnë detyrat e veta.